

VENDIM
Nr. 603, datë 31.8.2016

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 413, DATË 25.6.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË
PROCEDURAVE TË SHITJES SË TROJEVE NË PËRDORIM, SIPËRFAQE TË
DOMOSDOSHME, DHE TROJEVE SHITESË FUNKSIONALE TË
NDËRMARRJEVE, SHOQËRIVE TREGTARE, TË OBJEKTEVE SHTETËRORE
TË VEÇUARA, TË PRIVATIZUARA, TË OBJEKTEVE APO NDËRTESAVE TË
SHITURA TË ISH-KOOPERATIVAVE BUJQËSORE, SI DHE TË NDËRTESAVE
TË NDËRTUARA NË BAZË TË LEJEVE TË NDËRTIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", të ligjit nr. 10270, datë 22.4.2010, "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij", të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.9.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 413, datë 25.6.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen procedurat e privatizimit të truallit, sipërfaqe e domosdoshme, për objektet pjesë e kapitalit të shoqërive tregtare (shoqërive me kapital të përbashkët dhe shoqërive aksionare), kapitali i të cilave zotërohet plotësisht apo pjesërisht nga shteti dhe shitja e tyre është bërë nëpërmjet procedurave të likuidimit. Shitja e truallit, sipërfaqe e domosdoshme, për këto objekte do të bëhet në përputhje me genplanin në momentin e shitjes së tyre."

b) Në fund të shkronjës "c", të pikës 3, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Kopjen e noterizuar të kontratës së shitjes për objektin, të nënshkruar me likuidatorin e shoqërisë, së bashku me genplanin apo planrilevimin e përgatitur nga ekspert i licencuar në momentin e shitjes."

c) Pas shkronjës "b", të pikës 4, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, duhet të dërgojë kopjen e konfirmuar të dokumen-tacionit të shitjes së objektit sipas procedurave të likuidimit, për të cilin kërkohet privatizimi i truallit."

ç) Në fund të pikës 11 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Në rast se edhe nga organet e sipërpërmendura nuk gjendet dosja e vlerësimit (privatizimit apo dokumentacionit që i mungon dosjes) të objektit, atëherë Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, pranon dosjen e privatizimit që ka paraqitur blerësi i objektit apo ndërmarrjes, (kontratën e shitjes, aktin e dorëzimit, autorizim për kalim pronësie, genplanin apo planimetrinë dhe mandatpagesat përkatëse), të njohura këto me vendim gjykatë të formës së prerë."

2. Në kreun II bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në fund të pikës 2 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, kryen edhe procedurat e

shitjes së trojeve shtesë funksionale të shoqërive me kapital të përbashkët dhe të shoqërive aksionare të privatizuara dhe atyre të shitura me procedurat e likuidimit.”.

b) Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave, mund t’i kërkojë bashkisë përkatëse nëse trualli, i cili kërkohet të privatizohet, përdoret për interes publik apo edhe është pronë e saj, i transferuar në bazë të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Në rastet kur ka informacion për truallin që do të shitet se është pjesë e listave të inventarit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, por të patransferuara, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme (AITPP).”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama